



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT  
14-020/04-54986 më 16 APR 2026

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, nenit 44, paragrafi 3 të Rregullores (QRK) nr. 22/2020 për riintegrimin e personave të riatdhesuar, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet caktimi i Komisionit Komunal për Riintegrimin e personave të riatdhesuar.
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, anëtarë të komisionit caktohen:
  1. Munavere Qerkezi, kryesuese;
  2. Jehona Krasniqi, zëvendësuese;
  3. Ajshe Bërveniku, anëtare;
  4. Argjentina Deliu, anëtare;
  5. Visar Jashari, anëtar;
  6. Krenare Abdullahu, anëtare;
  7. Habib Qorri, anëtar;
  8. Valon Bicaj;
  9. Valentina Mehmeti, anëtare.
3. Sipas pikës 1 dhe 2 të këtij Vendimi, bazuar në Rregulloren (QRK) nr. 22/2020 për riintegrimin e personave të riatdhesuar, komisioni është organ vendimmarrës në nivel lokal, i cili shqyrton dhe vendos për kërkesat e personave të riatdhesuar për përfitim nga skemat e riintegrimit, si në vijim: akomodim me qira, asistencë mjekësore, rindërtim dhe/ose renovim të shtëpive, pako të orendive shtëpiake.
4. Komisioni/Komuna mbështetë personat e riatdhesuar në regjistrimin civil, pajisjen me dokumente personale, regjistrimin në shkolla, kujdesin shëndetësor, aftësimin profesional dhe punësimin.
5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi 01. Nr. 14-020/04-54807/22 i dt. 11.03.2022.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U DORËZOHET:

- Anëtarëve të komisionit;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT  
Përparim Rama

